



01 Nr. 332/25 Dt. 02.06.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 paragrafi g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 37 të Ligjit 06/L-82, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale

1. Shpejtim Rramanaj, udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë në Drejtorinë e Shëndetësisë në Komunën e Prizrenit, caktohet si zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale në Komunën e Prizrenit.
2. Detyra dhe përgjegjësit e zyrtarit të caktuar në pikën 1 të këtij Vendimi janë të parapara në Ligjin 06/L-82, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.
3. Me këtë Vendim shfuqizohet vendimi nr. 01 nr. 625/23, i datës 21.09.2023.
4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
5. Obligohet zyrtari i lartcekur për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➤ Vendimi iu dërgohet:

- Të lartcekurit,
- Besnik Thaqi-ish zyrtar për mbrojtjen e të dhënave,
- Agjencisë për Informim dhe Privatësi,
- Njësisë së Burimeve Njerëzore,
- Arkivës së Kryetarit.

